



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

V E N D I M

Nr. 6, datë 22.05.2013

**“MBI MIRATIMIN E PAGESAVE PËR SHËRBIMET QË KRYHEN NGA AUTORITETI I MEDIAVE
AUDIOVIZIVE”**

Në mbështetje të gërmës f, të pikës 1 dhe pikës 16 të nenit 19 si dhe pikave 1 dhe 2 të nenit 25 të ligjit nr. 97/2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, Autoriteti i Mediave Audiovizive,

VENDOSI:

1. Të miratojë pagesat si më poshtë:

1. Pagesat për marrje licence

Masa e pagesave për marrjen dhe rinovimin e licencës dhe/ose autorizimit për ofruesit e shërbimit mediatic audio dhe/ose audioviziv është:

- Për shërbim programi audio dhe/ose audioviziv mbështetur në rrjet numerik kombëtar 50.000 lekë
- Për radio analoge vendore 15.000 lekë
- Për shërbim programi audio dhe/ose audioviziv mbështetur në rrjet numerik lokal ose rajonal 30.000 lekë

2. Pagesat për përpunim dokumentacioni

Masa e pagesave për përpunimin e kërkesave për licencë për:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

• Radio transmetues analog vendor	20.000 lekë
• Radio kombëtare FM, transmetues analog	40.000 lekë
• Transmetime radiotelevizive me kabëll	40.000 lekë
• Transmetime radiotelevizive me satelit	50.000 lekë
• Ritransmetim të programeve televizive ose radio me përsëritës	20.000 lekë
• Licencë (leje) për ritransmetim programesh	55.000 lekë
• Operatorët numerik të rrjeteve kombëtare	200.000 lekë
• Operatorët numerik të rrjeteve rajonale	150.000 lekë
• Operatorët numerik të rrjeteve vendore	100.000 lekë
• Operatorët numerik të programit	100.000 lekë
• Operatorët e rrjetit numerik satelitor	100.000 lekë
• Autorizimet për shërbimet	50.000 lekë

3. Pagesat për shërbimet

- Tarifa e shërbimit për lëshimin e materialeve autentike të depozituara në Arkivën e AMA-s, për çdo fletë të fotokopjuar 15 lekë
- Tarifa për marrjen e dokumentacionit dhe regjistrimit 1.000 lekë
- Tarifa e shërbimit për lëshimin e materialeve autentike të kaluara në DVD, (për çdo muaj, për një orë/DWD) 1.400 lekë
- Tarifa e shërbimit për lëshimin e materialeve autentike të transkriptuara, (për çdo fletë) 1.000 lekë
- Shpenzimet e monitorimit të frekuencave që do të bëhet me kërkesë të subjekteve, do të likuidohen nga subjekti i cili e kërkon këtë shërbim, në bazë të një preventivi të përgatitur nga AMA dhe të miratuar nga subjekti.
- Shpenzimet e monitorimit të programeve që do të bëhet me kërkesë të subjekteve, do të likuidohen nga subjekti i cili e kërkon këtë shërbim, në bazë të një preventivi të përgatitur nga AMA dhe të miratuar nga subjekti.

2. Në të gjitha rastet e përcaktuara në këtë vendim, pagesa e tarifë do të parapaguhet.

3. Pagesa për marrjen e licencave ose autorizimit bëhet në momentin e marrjes së licencës ose autorizimit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

4. Pagesat do të kryhen në llogaritë bankare të AMA-s.

5. Vendimet e Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit, nr. 24, datë 23.10.2000 “Mbi caktimin e pagesave për marrjen dhe rinovimin e licencave”, i ndryshuar, nr. 33, datë 11.12.2000 “Mbi caktimin e tarifave të shpërblimit për pjesëmarrje në mbledhje e të tarifave për shërbime të ndryshme”, i ndryshuar dhe nr. 274, datë 30.04.2004 “Mbi tarifatat për transmetime RTV”, i ndryshuar, shfuqizohen.

6. Ngarkohet administrata e Autoritetit të Mediave Audiovizive për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

Kryetar:	Prof.As. Endirë	BUSHATI
Zëvendëskryetar:	Sami	NEZAJ
Anëtarë:	Gent	IBRAHIMI
	Suela	MUSTA
	Zylyftar	BREGU (Në mungesë)